

URDHËR
Nr. 108, datë 10.7.2025

**PËR CAKTIMIN E ZËVENDËSDREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË
SË MBIKËQYRJES POLICORE PËR USHTRIMIN E KOMPETENCAVE DHE
DETYRAVE TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË SË
MBIKËQYRJES POLICORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 19, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”,

URDHËROJ:

1. Caktimin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, z. Artjol Saliasi, për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

2. Kompetencat e deleguara sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohen deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendës drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSSHËM
Ervin Hoxha